



# SHOQATA E KOMUNAVE TË SHQIPËRISË

*Mundësia më e mirë për Komunitet dhe drejtuesit e tyre!*

Nr.5. Maj 2008. Organ i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë.

Adresa: Rr. "Dervish Hima", Kulla 2, Apt.33 (mbrapa stadiumit "Qemal Stafa"), Tirana - Albania. P.O. Box. 2377.

Tel&Fax: +355 4 22 59 318. E-mail: aac@abcom.al. Webpage: www.aac-al.org.

## EDITORIAL

**SHKSH, organizatë aktive dhe autoritare në arenën qeverisëse në Shqipëri**



Nga: **AGRON HAXHIMALI**  
Drejtor Ekzekutiv

**P**rioriteti kryesor i SHKSh-së është ndikimi i saj në forcimin e qeverisjes vendore në komunat e Shqipërisë. Për këtë qëllim, Shoqata ka bërë dhe po bën përpjekje të vazhdueshme duke përdorur forma e metoda bashkëkohore e duke sjellë përvoja të përparura për të nxitur e ndikuar në arritjen e standarteve të rinj të qeverisjes, në përshtatje me stadin aktual të zhvillimit. SHKSh, është kthyer tashmë në një organizatë autoritare e aktive në arenën e qeverisjes në Shqipëri.

Në zbatim të planit të vet strategjik SHKSh ka përcaktuar qartë strategjitë e programin e veprimtarisë e të shërbimeve, ka zhvilluar e miratuar një sërë dokumentesh strategjikë, ku padyshim, Strategjia e Avokatisë dhe Lobimit është një ndër dokumentet që ravijëzon qasjet, mjetet dhe metodat për menaxhimin e rolit avokator dhe lobues të SHKSh.

(Vijon në faqen 2)

## Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë, z.Sabri Sallaku, viziton zonën e Gërdecit

**K**ryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë, z.Sabri Sallaku, i shoqëruar dhe nga Nën/kryetari z. Ylli Kupi, vizitoi zonën e Gërdecit e cila u dëmtua rëndë nga tragjedia e 15 marsit 2008.

Në takimet e veçanta që zhvilloi z. Sallaku me kryetarin e Bashkisë së Vorës, z. Fiqiri Ismaili si dhe me kryetarin e komunës së Maminasit, z. Dashnor Osmani, në emër të kryesisë së Shoqatës, shprehu ngushëllimet e sigjerta për familjet që humbën të afërmit e tyre në këtë tragjedi.

Z. Sallaku tha se, ashtu si mbarë populli shqiptar, edhe Shoqata e Komunave të Sh-



qipërisë, e përjetoi këtë ngjarje të jashtëzakonshme me dhimbje të madhe. Duke u njohur me dëmet e shkaktuara nga kjo

tragjedi në këto njësi vendore, në emër të Shoqatës së Komunave të Shqipërisë, ai bëri prezent solidaritetin e gatishmërinë e komu-

nave të vendit, për të ofruar një kontribut, në ndihmë të komuniteteve të dy njësive të qeverisjes vendore të prekura nga kjo fatkeqësi. Ky kontribut do të ndihmojë në lehtësimin dhe eliminimin e pasojave të familjeve të këtyre njësive vendore.

Për t'u njohur më konkretisht me situatën e krijuar në Komunën e Maminasit të rrethit të Durrësit, që ishte nën veprimin e rrezes së shpërthimit të Gërdecit, dhe përpjekjet që po bëhen për eliminimin e pasojave, zhvilluan bisedën e mëposhtme me kryetarin e Komunës së Maminasit, Zotin Dashnor Osmani.

(Vijon në faqen 3)

## KOMUNAT PËRBALLË SFIDAVE TË REJA TË TAKSAVE E TARIFAVE VENDORE

- SHKSH, trajnime në 12 qarqet e vendit për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore -

**Z**hvillimet ekonomiko - shoqërore të Shqipërisë, stadi aktual i arritjeve si rezultat i zbatimit të reformave evropianizuese dhe veçanërisht thellimi i procesit të decentralizimit ka vënë përballë sfidave të reja njësive të qeverisjes vendore, drejtimi i të cilave kërkon gjithnjë e më shumë rritjen e profesionalizmit të drejtuesve. Një nga sfidat e reja me të cilat përballen sot komunat janë taksat dhe tarifave vendore. Shoqata e Komunave të Shqipërisë duke ndjekur me vëmendje dukuritë e reja në sistemin e taksave në komuna, në programin e veprimtarive të saj fokusoi menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore. Në bashkëpunim edhe me Shoqatën e Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Suedisë, Shoqatën e Bashkive Hollandeze dhe Fondacionin FLAG, SHKSH hartoi dhe prezantoi një program të posaçëm nëkas me drejtuesit dhe administratën përkatëse të Komunave të Shqipërisë me synim menaxhimin e taksave

dhe tarifave vendore sipas dukurive bashkëkohore.

Në të 12 qarqet e vendit SHKSH planifikoi dhe zhvilloi 12 seminare trajnimi njëditore, me pjesëmarrjen e drejtuesve dhe punonjësve të sektorit të taksave të komunave. Në themel të programit u vu mënyra se si duhen menaxhuar taksat e tarifave vendore në këtë stad të ri me synim përmirësimin e kapaciteteve menaxhuese në fushën e vendosjes, mbledhjes dhe administrimit të taksave dhe tarifave vendore në komuna. Programi u ndërtua në mënyrë të tillë që t'i përgjigjej detyrimeve ligjore të komunave që rrjedhin nga Ligji 9632, datë 30/10/2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" si dhe udhëzimeve përkatëse nga ministritë e linjës.

Pjesëmarrësit në trajnime shfaqën interes maksimal për programin, për idetë e problemet bashkëkohore që paraqiten në këtë fushë. Për këtë arsye menaxhimet ditore në qarqe u zhvilluan në frymën e debatit e



diskutimeve konstruktive dhe vlejën jo vetëm si shkolla për marrjen e njohurive bashkëkohore nga pjesëmarrësit, por dhe për të përgjithësuar përvojat e më të mirëve.

Objektivat e trefishtë që ishin vënë në program për t'i realizuar si: Përmirësimi i aftësive të drejtuesve dhe punonjësve të sektorit të taksave të komunave në organizimin e punës dhe ushtrimin e funksioneve të tyre; Informimi i punonjësve të sektorit

të taksave pranë komunave me kuadrin ligjor për taksat vendore; Identifikimi dhe përhapja e përvojave të përparura në fushën e menaxhimit të taksave vendore, u realizuan mjaft mirë.

Pjesëmarrësit gjatë diskutimeve e debateve ngritën shqetësime e probleme specifike sipas komunave, dhanë mendime, bënë propozime si dhe këmbyen përvojat e tyre për zgjidhjet e problemeve.

## Pjesmarrja qytetare në qeverisjen vendore në zona rurale



- Ka përfunduar trajnimi me këshilltarët dhe kryetarët e fshatrave
- Marrëdhëniet midis grupeve të interesit të ndertohen në një klimë pozitive e mirëbesimi duke rritur transparencën dhe lufta kundër korrupsionit

**P**jesmarrja qytetare në qeverisjen vendore, në zona rurale është projekti që ka nisur të realizohet qysh në janar të këtij viti dhe që do të përfundojë në muajin nëntor 2008. Projekti mbështetet nga Ambasada e Mbretërisë së Vendeve të Ulta dhe menaxhohet nga SHKSH. Ai po gjen zbatim në pesë komuna të Shqipërisë, konkretisht në Maminas-Qarku Durrës, Qender Bulgarec-Qarku Korçë, Rrethinat-Qarku Shkoder, Gjinar-Qarku Elbasan, Novosele-Qarku Vlorë. Qëllimi i këtij projekti është promovimi dhe rritja e kapaciteteve të grupeve të interesit në komunat partnere për të qënë aktiv dhe proaktiv në proceset vendimarrëse të qeverisjes vendore.

Projekti është duke u zbatuar sipas pro-

gramit dhe për shkak të tematikës interesante: Pjesmarrja qytetare në qeverisjen vendore, po ndiqet me interes nga pjesëmarrësit.

Deri tani, në të pesë komunat, kanë përfunduar trajnimet me këshilltarët dhe kryetarët e fshatrave ku janë prezantuar sipas programit temat: roli dhe funksioni i kryetareve të fshatit si nderlidhes, teknikat e komunikimit, procedurat për organizimin e takimeve etj. Ndërsa për këshilltarët janë prezantuar temat: Karta Europiane e Vetqeverisjes Vendore, roli dhe funksioni i këshillit, rregullorja e funksionimit të këshillit, strategjia e decentralizimit.

Së shpejti do të nisnin trajnimet me forumet e grave dhe ato të rinjve. Me forumin e



grave dhe të atë të rinjve do të zhvillohen temat për decentralizimin, mundësitë dhe sfidat e komunitetit në QV, hartimi i draft-strategjisë së komunikimit, rritja e transparencës etj.

Projekti parashikon edhe organizimin e dy workshopeve në zyrat e SHKSh,

Projekti për pjesëmarrjen qytetare në qeverisjen vendore do të ndikojë që komunitet të jene më aktiv në vendimarrje, që puna e kryetareve të fshatit të jete me cilesore, që të krijohet një imazh i mire për komunën dhe këshillat e komunave, që mardhenjet midis grupeve të interesit të ndertohen në një klimë pozitive dhe mirbesimi e të rritet transparencën dhe lufta kundër korrupsionit.

## FTESË

Redaksia e gazetës Shoqata e Komunave të Shqipërisë, për t'iu ardhur në ndihmë komunave, fshatrave, bizneseve, marr përsipër të botojë reklama, njoftime, komunikata etj. kundrejt një pagese të arsyeshme. Botimi i reklamave do të ndihmojë në reklamimin e biznesit tuaj si dhe do ta kthejë gazetën në një mjet informimi e komunikimin për bizneset që veprojnë në komunat tuaja gjë që do të ndikojë në lëvrimin e shitjen e këmbimin e mallrave.

Redaksia fton të gjithë biznesmenët, këshillat, kryetarët e komunave, kryetarët e fshatrave që të ndikojnë në botimin e reklamave.

Jeni të mirëpritur!  
**REDAKSIA**

## Forumet Profesional do të sensibilizojnë komunitet me praktikat më të mira bashkëkohore

**-Mblidhen Forumet Profesionale; i Sekretarëve të Këshillave të Komunave si dhe ai i Financave, Taksave e Tarifave Vendore-**

Më 2 Prill dhe 3 prill 2008, në mjediset e SHKSH, u mbledhën përkatësisht; Forumi Profesional i Sekretarëve të Këshillave të Komunave dhe Forumi Profesional i Financave, Taksave dhe Tarifave Vendore. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga të gjitha komunat e vendit.

Aida Cenaj, juriste e SHKSH, në fjalën e hapjes së forumit të sekretarëve të këshillave të komunave, theksoi se Forumi Profesional mund të sensibilizojnë komunitet me praktikat më të mira të evidentuara. Pjesëmarrësit në forum u njohën me Guidën Procedurale të Forumeve Profesionale, e cila parashikon rregullat për organizimin dhe funksionimin e forumeve.

Zj. Marie Elisabeth Pernebring, eksperte në fushën e qeverisjes vendore me përvojë të gjatë pune në Suedi, solli në forumin Profesional të Sekretarëve të Këshillave të Komunave (FP-SK) shembuj rreth dialogut konsultues ndërmjet shoqatave të qeverisjes vendore dhe qeverisë qendrore në Suedi, Danimarkë dhe Finlandë.

Ndërsa z. Bjorn Sundstrom, me eksperience 35 vjeçare ne Shoqatën e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale Suedeze, ne Forumin Profesional të Financave, Taksave dhe Tarifave Vendore, prezantoi shembuj rreth procedurave dhe përqasjeve strategjike për të adresuar çështjet financiare me interes të përbashkët për komunat. Z. Bjorn shpjegoi faktorët që

mbahen parasysh në Suedi gjatë ndarjes së grantit për te garantuar barazinë horizontale për njësitë vendore.

Forumet i zhvilluan punimet në sesione ku diskutuan dhe prezantuan problematikat aktuale specifike për çdo forum.

Në Forumin Profesional të Sekretarëve të Këshillave u përcaktuan si problematika parësore: roli dhe funksionet e vet forumit, në kuadër të funksionimit më të mirë të Këshillave të Komunave ku u paraqit edhe një model Rregulloreje e Brendshme e Funksionimit të Këshillit të Komunës, e cila do të diskutohet në mbledhjet e radhës së forumit me qëllim hartimin e një modeli unik për t'ia paraqitur më pas Komisionit të Përhershëm të



Ligjeve të ShKSH. Gjithashtu u përcaktuan edhe hapat e mëtejshëm të punës për takimin e radhës. Grupet e punës propozuan si parësore një sërë problematikash të cilat u grupuan sipas kategorive dhe konkretisht në: Njohuritë e pamjaftueshme të këshilltarëve dhe Seanca dëgjimore jo të rregullta.

Forumit Profesional i Financave, Taksave dhe Tarifave Vendore u prezantuan si problematika Grumbullimi i të ardhurave, kuadri ligjor, dokumentet stan-

darde etj.

Forumet zgjedhën organet drejtuese. Forumi Profesional i Sekretarëve të Këshillave të Komunave zgjodhi kryesinë e tij. Z. Njazi Deliu, komuna Z. Dajt u zgjodh kryetar ndërsa Z. Ndrim Çela, komuna Papër, u zgjodh nënkryetar.

Forumit Profesional i Financave, Taksave dhe Tarifave Vendore zgjodhi kryetare znj. Florinda Ndoja nga komuna Rrethinat dhe nënkryetar z. Agim Hoxha nga komuna Velipojë.

### SHKSH, organizatë aktive dhe autoritare në arenën qeverisëse në Shqipëri

(Vijon nga faqja 1)

Kjo strategji, e cila identifikon mënyrat e ndërveprimit me Qeverinë Qendrore, partnerët strategjikë dhe me median për të mbrojtur interesat e komunave e qëndrimet e ShKSH për çështjet me interes komunar duke synuar ndikimin mbi procesin e formulimit të politikave në nivel qendror kuadrin rregullator për funksionimin e qeverive komunare.

Avokatia është një nga shërbimet thelbësore që ShKSH po i ofron anëtarëve të saj, duke mundësuar unifikimin e fuqisë individuale të qeverive komunare në një përpjekje kolektive dhe të organizuara për t'iu paraqitur vendimmarrësve dhe opinionbërësve opinionet, vlerësimet dhe kërkesat e tyre.

Strategjia e Avokatisë dhe Lobbimit ka identifikuar si një nga objektivat prioritarë rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit të qëndrueshëm mes ShKSH e organizatave analoge në Shqipëri si Shoqata e Bashkive, Shoqata e Këshillave të Qarqeve si dhe me institucionet shtetërore me qëllim promovimin e qëndrimeve dhe politikave të komunave që shkojnë në dobi të komuniteteve. Kjo strategji ka identifikuar si mjet Memorandumin e Mirëkuptimit mes ShKSH, shoqatave analoge dhe qeverisë qendrore me qëllimin që bashkërisht të zbatojnë një marrëveshje e cila do të vendosë një kornizë parimesh e angazhimesh që do të lehtësojnë punën e përbashkët mes qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore në shërbim të qytetarëve shqiptarë.

Edhe në drejtim të bashkëpunimit ShKSH, ka luajtur një rol të vecantë ku është përpjekur dhe ka ndikuar në krijimin e një klime të bashkëpunimit e mirëkuptimit reciprok në tërë arenën e qeverisjes, por sidomos në përpunimin e sjelljen e një fryme të re mirëkuptimi brenda këshillave të komunave duke zbehur përkatësitë partiake të këshilltarëve e duke orjentuar arritjen e objektivave në interes të komunitetit të komunave.

Po ashtu, në zbatim të misionit të vet për unifikimin e "zërit" dhe veprimin të qeverive komunare dhe prezantimin e tyre në nivel vendor, qendror dhe ndërkombëtar, ShKSH ka arritur rezultate të dukshme të padiskutueshme në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komunave.

Edhe në të ardhmen ShKSH, duke ngitur më tej cilësinë e veprimit të saj do të vazhdojë të jetë një faktor i rëndësishëm i bashkëpunimit ndërqeverisës, me partnerët strategjikë si dhe brenda këshillave duke u afirmuar gjithnjë e më shumë si një organizatë me autoritet të padiskutueshëm e aktive në arenën e qeverisjes në Shqipëri.

## LEGJISLACIONI I RI NË NDIHMË TË NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

ËSHTË MIRATUAR

Ligi nr. 9869, "Për Huamarrjen Vendore" datë 04.02.2008

Ligji për Huamarrjen Vendore, miratuar në shkurt të këtij viti parashikon mundësinë e huamarrjes nga njësitë e qeverisjes vendore. Huamarrja mund të përdoret nga këto njësi si për likuiditete dhe për investime të lidhura me të gjitha funksionet vendore.

Ligji është hartuar në respektim të plotë të parimeve të autonomisë së decentralizimit fiskal vendor. Ky ligj parashikon huamarrje afatgjatë dhe afatshkurtër që mund të merren nga banka apo tregje kapitale vendase apo të huaja.

Theksojmë se njohja e këtij ligji nga këshillat e komunave është një nevojë imediate pasi këshilli është organi që mund të marrë hua.

PO REALIZOHET PROJEKTI:

Modernizimi i Shërbimit të Gjendjes Civile

Ministria e Brendshme po realizon projektin "Modernizimi i Shërbimit të Gjendjes Civile" e ndihmuar nga grupi i Asistencës Teknike të OSBE-së, Tiranë dhe Statistics Norway.

Pëmes këtij projekti do të realizohen:

- Ndërtimi i Sistemit të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile
- Përcaktimi i numrit të identitetit për çdo shtetas
- Ngritja e një sistemi që do t'iu ofrojë informacion palëve të treta
- Informatizimi i shërbimit në të gjitha nivelet duke krijuar një sistem të përditësuar
- Ngritja e sistemit të adresave, duke bërë të mundur lidhjen e individit me terrenin.
- Ka filluar zbatimin e këtij projekti me hedhjen e të dhënave nga regjistrat themeltarë në formë elektronike. Qëllimi final i këtij projekti është krijimi i Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile, që do të mundësojë mbajtjen, dokumentimin elektronik të Gjendjes Civile dhe shërbimin online të Zyrave të Gjendjes Civile në mbarë vendin.
- Gjithashtu, Ministria e Brendshme po ndërton softin përfundimtar të Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile. Ky është një projekt shumë i dobishëm për tërë shqiptarët pasi vetëm përmes krijimit të këtij regjistrimi të saktë ata do të mund të kenë numër dhe kartë identiteti si në gjithë vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian.

Ky projekt ka gjetur zbatim në gjithë komunat e vendit.

ËSHTË DUKE U HARTUAR:

Projektligji "Për Zhvillimin Rajonal në Republikën e Shqipërisë"

Aktualisht është duke u hartuar Ligji për Zhvillimin Rajonal në Republikën e Shqipërisë, i cili ka si objektiva kryesore nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të ekuilibruar të gjithë rajoneve të Shqipërisë; rigjallërimin e zonave me disavantazhe të theksuara (të izoluar nga zhvillimi) dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërajonal të brendshëm dhe ndërkombëtar, të bash-

këpunimit ndërkufitar brenda kuadrit të Eurorajoneve si edhe të pjesëmarrjes në organizatat dhe strukturat Evropiane.

Zhvillimi rajonal, i parë si një proces afatgjatë i rritjes së zhvillimit të qëndrueshëm social dhe ekonomik që do të arrihet nëpërmjet identifikimit, stimulimit dhe menaxhimit të potencialit të zhvillimit të rajoneve individuale është një nga përbërësit kryesorë drejt përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së jetës në Republikën e Shqipërisë.

Politika e Zhvillimit Rajonal bazohet në disa parime të përcaktuara në projektligj. Ato janë:

**-Partneriteti dhe bashkëpunimi :**

Partneriteti në formën e bashkëpunimit ndërmjet sektorëve publikë, private dhe civilë dhe veçanërisht ndërmjet organeve shtetërore administrative qendrore dhe organeve administrative vendore.

**- Solidariteti dhe përqëndrimi**

Stimulimi i zhvillimit të zonave jo të favorizuara bazohet në solidaritetin e përbashkët të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe orientohet veçanërisht drejt mbështetjes shtesë të zonave që kanë mbetur shumë mbrapa mesatares kombëtare.

**- Mundësi të barabarta**

Politika e zhvillimit rajonal bazohet në domosdoshmërinë e krijimit të kushteve të jetesës në të cilat të gjithë qytetarët kanë mundësi të barabarta për të zhvilluar potencialin e tyre.

**- Planifikimi dhe Programimi**

Planifikimi dhe programimi i zhvillimit rajonal bazohet në dokumentet shumëvjeçare të planifikimit, të cilët përmbajnë një ose më shumë programe zhvillimi që mundësojnë realizimin e objektivave dhe prioritetëve bazë të deklaruara nga dokumentet e planifikimit.

### ShKSH propozon rishikimin e sistemit të pagave për punonjësit e organeve të qeverisjes vendore në komuna

Shoqata e Komunave të Shqipërisë ndjek me shumë vemendje dhe preokupim përgatitjen profesionale të drejtuesve të komunave e punonjësve të administratës së tyre me qëllim që qeverisja vendore t'iu përgjigjet ritmeve të zhvillimit dhe të jetë sa më pranë kërkesave dhe interesave të qytetarëve shqiptarë. ShKSH, është interesuar veçanërisht edhe për shpërbimin e drejtuesve të komunave. Për këtë arsye SHKSH, i bëri Departamentit të Administratës Publike të Ministrisë së Brendshme propozimet konkrete në kuadrin e rishikimit të sistemit të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore në komuna. Për të qënë sa më objektive në propozimet e veta SHKSH, organizoi diskutime e analiza në të gjitha komunat me drejtues, anëtarët, si dhe me punonjës të administratës.

Në përfundim të diskutimeve e analizave, u sollën argumentet përkatëse përse duhet të rishikohet e rregullohet sistemi i pagave i punonjësve të organeve të qeverisjes vendore. Pagat duhet të rriten sepse;



gama e problemeve në komuna ka ardhur vazhdimisht duke u shtuar, sepse volumi i punës është rritur, sepse zgjidhja e problemeve të anëtarëve të komunës në kushtet e decentralizimit të mëtejshëm dhe ritmeve që kërkohen paraqesin më shumë vështirësi, sepse kërkohej më shumë përgjegjësi e përkushtim.

Nisur nga këto kryesia e Shoqatës i bëri Departamentit të Administratës Publike të Ministrisë së Brendshme konkretisht pro-

## -Intervistë me kryetarin e Komunës së Maminasit, Zotin Dashnor Osmani-

**Zoti Kryetar, nëse ka mundësi, mund të na e përshkruani për lexuesit e gazetës sonë, situatën e shpërthimit të 15 marsit në Gërdec. Cilat ishin pasojat e kësaj ngjarje?**

Është shumë e vështirë të risillet në kujtesë ajo ngjarje. Në ato momente u krijua një situatë shumë tronditëse, pasi shpërthimi ishte i menjëhershëm dhe i papritur. Dëmet që shkaktoi ai shpërthim i jash-tëzakonshëm ishin të mëdha. Fillimisht ne verifikuam institucionet publike të komunës sepse qenë më pak. Kur pamë gjendjen në vend, menduam se tragjedia do të ishte më e madhe dhe më e dhimbshme nëse 15 marsi nuk do të kishte qëlluar ditë e shtunë, ditë pushimi për shkollat. E them këtë pasi shpërthimi kishte dëmtuar ndërtesat e shkollave, kishat shkatërruar dyer e dritare, kishat thyen xhama e kishat bërë plot dëmtime të tjera. Në fshatin Maminas u dëmtuan; një shkollë 9-vjeçare dhe një e mesme, ndërsa në fshatin Rubjek u dëmtua shkolla 9-vjeçare.

**Cilat ishin masat që morët ju si njësi e qeverisjes vendore për njohjen me dëmet e shkaktuara dhe përbalimin e menaxhimin e situatës?**

Kuptohet që për këshillin e



komunës dhe administratën ishte një provë e madhe. Kjo situatë duhej përballuar patjetër nga njësi e qeverisjes vendore. Që në momentet e para të passhpërthimit u mbledhëm, diskutuam e vendosëm që në radhë të parë të njiheshim me fatkeqësitë njerëzore, me evadimin e strehimitin e njerëzve që u ishin dëmtuar shtëpitë, pastaj të verifikonim një për një të gjitha dëmet e shkakuar, të ç'natyre ishin, dhe mandej si do ta përbaltonim e menaxhonim situatën... Me cilësinë e Kryetarit të Komunës Maminas dhe të Kryetarit të Shtabit të Emergjencave mbledha Shtabin e Emergjencave, Këshillin e Komunës dhe kryetarët e fsha-

trave. Me mbështetjen edhe të deputetit të zonës, Z. Sami Gjergji, ngritëm grupet e punës për secilin fshat për të verifikuar dëmet e shkaktuara. Në përbërje të grupeve caktuam këshilltarët, punonjës të administratës, kryetarët e fshatrave dhe specialistë ndërtimi. Këto grupe filluan menjëherë punën për verifikimin dhe vlerësimin e dëmeve, objekt për objekt.

**Cilat ishin dëmet dhe si po procedohet për eliminimin e pasojave të tyre?**

Me miratimin nga Këshilli i Ministrave të Vendimit Nr. 313, datë 23 mars 2008, vendim që përfshiu dhe komunën tonë, dhe që bënte fjalë për ngritjen e komisioneve të verifikimit, ne ngritëm komisionin të përbërë nga 5 anëtarë, 3 nga komuna dhe 2 specialiste të Qarkut. Komisioni filloi menjëherë verifikimin objekt për objekt. Dhe pas verifikimit u plotësuan formularët përkatës. Komisioni verifikoi 982 objekte në shkallë komune konkretisht: në fshatin Maminas 177, Rubjek 258, Bilalas 167, Rrec 221, Vlashaj 138 dhe Metallaj 21. Formularët e plotësuar, pasi u konfirmuan nga Këshilli i Qarkut, u përcollën tek Enti Kombëtar i Banesave. Enti i banesave është institucioni që bën përfundimisht vlerësimin e dëmit. Nga 982 formularë të plotësuar

janë vlerësuar 789 dhe vlera në lekë arrin shumën 35 934 102. Për 133 formularët e tjerë ende nuk është marrë konfirmim.

**A keni pasur mbështetje nga Qeveria Qendrore ose nga organizma apo donatorë të tjerë vendas a të huaj për të eliminuar sa më shpejt pasojat?**

Nuk na janë afruar as organizma e as donatorë të tjerë për të ndihmuar, as të vendit e as të huaj.

Nga komuna u punua për restaurimin e 3 shkollave që u dëmtuan gjatë shpërthimit. Ato u pajisën me xhama, me dyer e vetrata. Nga qeveria është premtuar, por deri tani nuk ka patur ndonjë ndihmë konkrete.

Unë në emër të komunitetit të komunës do të kërkoja përshtetjen dhe dhënien e ndihmave financiare që banorët të fillojnë menjëherë nga puna për ndërtimin e restaurimit e shtëpive etj. Kjo do të qetësonte disi komunitetin do të sensibilizonte opinionin dhe do të kthehej në normalitet gjendja e tyre psikologjike e tronditur aq shumë.

## Strategjia e Lëvrimit të Shërbimeve një imazh i ri i kohës

Më 8 maj Komitetit Drejtues i SHKSH do të diskutojë për ta miratuar Projektin e Strategjisë së Lëvrimit të Shërbimeve. Lëvrimi i shërbimeve për SHKSH përbën një nga prioritetet kryesore dhe për këtë arsye Strategjia e Lëvrimit të Shërbimeve është kthyer në domosdoshmëri.

Projekt Strategjia e Lëvrimit të Shërbimeve i paraprin aftësimin të strukturave të SHKSH për të kryer këtë funksion thelbësor në mënyrë sa më frytdhënëse. Është kjo arsyeja që Komisioni i Shërbimeve është angazhuar në rishikimin dhe vlerësimin e rezultateve të nxjerra nga anketimi, rezultate të cilat në takimin e Komisionit të Shërbimit të shoqatës janë shqyrtuar në formën e Planit Strategjik formular me qëllim të Objektivat e shoqatës në fushën e Lëvrimit të Shërbimeve.

Dihet se si pikënisje në përpilimin e kësaj strategjie shërbimeve anketimi i ndërmarrë në të gjitha komunat e vendit. Në anketim morën pjesë 126 kryetarë komunash, të cilët përfaqësojnë një bashkësi prej 845.114 vetësh,

pozimet e mëposhtme:

- Per Komunat me popullsi deri 5000 banore: Paga e kryetarit të komunës të jetë nga 60.000 – 80.000 lek. Paga e nenkryetarit të komunës te variojë nga 40.000 – 55.000 lek.

- Per Komunat me popullsi mbi 5.000 banore; Paga e kryetarit të komunës të jetë: nga 90.000 – 120.000 lek, ndërsa paga e nenkryetarit të komunës te variojë nga 50.000 – 70.000 lek.

- Gjithashtu SHKSH propozon një rritje prej 50 % të pagave për punonjësit e Administratës së Komunave të të gjitha niveleve.

SHKSH nuk do të rreshtë së kërkuar realizimin e këtyre propozimeve. Shoqata ka bindjen se miratimi i rritjes së pagave nga qeveria qendrore do të sjellë përkushtim më të madh në punë të drejtuesve të komunave e të punonjësve të administratës vendore.

- **Projektstrategjia e Lëvrimit të Shërbimeve - një nga prioritetet kryesore të SHKSH - Për miratimin e Projektstrategjisë ndërmerret një anketim i gjërë në të gjitha komunat e vendit.**

ose rreth 50 përqind të të gjithë popullsisë së komunave të vendit. Drejtuesit e komunave dhanë mjaft ide, mendime e sugjerime interesante të cilat u trupëzuan në këtë strategji. Miratimi i Strategjisë së Lëvrimit të Shërbimeve në këtë stad zhvillimi të shoqërisë në Shqipëri është bërë një kërkesë e domosdoshme dhe merr një rëndësi edhe më të madhe pasi jemi përballë sfidave të reja që rrjedhin nga kushtet e reja të zbatimit të decentralizimit, thellimit të reformave, por edhe të globalizimit. Ofrimi i shërbimeve, pra, po bëhet përherë e më i rëndësishëm pasi procesi i decentralizimit po ecen dhe qeveritë vendore përballesh me një spektër të gjerë funksionesh për të cilat nuk kanë përvojën e duhur.

Miratimi i Projektstrategjisë së Lëvrimit të Shërbimeve duke plotësuar kuadrin e katër strategjive mbështetëse të përcaktuara për të përmirësuar qëllimet dhe objektivat e Planit Strategjik do të sjellë një imazh të ri për Shoqatën e Komunave të Shqipërisë.

Mbi bazën e Strategjisë së Lëvrimit të Shërbimeve shoqata, në të ardhem, në mënyrë të planifikuar do t'i ofrojë ide e praktika moderne bashkëkohore qeverisjes vendore për të lëvruar një numër shërbimesh. Sfondi për lëvrimin e shërbimeve nga shoqata është mjaft i gjërë. Të lëvrosh shërbime kërkohen investime të mëdha në burime njerëzore dhe financiare. Gjithsesi katër janë shërbimet themelore: Shërbime informimi dhe dokumentimi; Shërbime këshillimi; Trajnimi dhe Shërbime ekonomike e financiare.

Ofrimi i këtyre shërbimeve do të përbëjë edhe funksionin thelbësor për shoqatat. Në bazë të strategjisë së Lëvrimit të shërbimeve, SHKSH do t'iu ofrojë shërbime për anëtarësinë do të jetë edhe më afër njësive të qeverisjes vendore, si dhe do të forcojë pozitivat e saj pasi përkushtimi dhe vlerësimi i komunave do të rritet falë lëvrimit të shërbimeve. Kuptohet, lloji i shërbimeve që do të ofrohen nga shoqata do të varet edhe nga zhvillimi i saj dhe nevojat e anëtarëve.

Në vetvete, Plani Strategjik, adreson çështje të lëvrimit të shërbimeve në një sërë mënyrash. SHKSH të ofrojë ekspertizën e saj në mënyrë që qeverisja vendore të ngrejë cilësinë e shërbimeve ndaj komunitetit në nivele të përafërta me vendet e BE duke shfrytëzuar eksperiencat më të mira vendase dhe të huaja. Nga ana tjetër bëhet e domosdoshme nxitja e bashkëpunimit institucional mes komunave homologe brenda dhe jashtë Shqipërisë si dhe garantimi i një bilanci financiar të qëndrueshëm që mundëson një funksionim të pavarur të SHKSH.

Disa nga veprimtaritë paraprake parashikuar në secilin prej qëllimeve të strategjisë janë parashikuar të fillojnë dhe kjo do të çonte në një zbatim të plotë të strategjisë. Duke u mbështetur në vlerësimet e komisionit të shërbimeve dhe kërkesat e shfaqura për qëllimet që duhet të arrihen, ndonëse mjaft prej tyre do të vihen në jetë në mënyrë të njëkohshme, është përcaktuar një renditje përparësish për bashkëpunimin ndërkomunal e përpilimin e modelstrukturës organizative, rregullorja e funksionimit të komunave, si dhe shërbimet prioritare që SHKSH do të ofrojë për anëtarët e saj.

## MEMORANDUMI I MIREKUPITIMIT – PIKE KULMORE NE PROCESIN E DECENTRALIZIMIT

-Memorandumi Mirëkuptimi do të çojë në një stad më të lartë marrëdhëniet mes qeverisjes vendore dhe asaj qendrore, por nuk synon të krijojë marrëdhënie të detyrueshme ligjore ndërmjet palëve -

Partneritetin mes Njësive të Qeverisjes Vendore dhe Qeverisjes Qendrore, SHKSH e ka parë dhe e sheh si elementin më thelbësor për krijimin e një bashkëpunimi e respekti të ndërsjellë ndërmjet hallkave të qeverisjes. Në kuadrin e ambicieve që ka SHKSH, për ta ngritur në një stad më të lartë veprimtarinë e organeve të qeverisjes vendore ka përcaktuar strategjitë e saj si dhe ka ndërmarrë nisma për thellimin e bashkëpunimit mes qeverisjes vendore dhe asaj qendrore. Kjo strategji ka identifikuar si mjetin më efikas për t'ia arritur këtij qëllimi, Memorandumin e Mirëkuptimit. Projekti i këtij Memorandumi është iniciuar, ideuar e përgatitur nga Shoqata e Komunave të Shqipërisë dhe pas diskutimesh pritet miratimi e nënshkrimi. Ç'përmban në vetvete projekti i Mem-

orandumi të Mirëkuptimit dhe çfarë pritet të zgjidhë? Memorandum i Mirëkuptimit është një tërësi parimesh, rregullash e angazhimesh dhe ka në themel ngritjen në nivelet më të larta të bashkëpunimit mes Qeverisjes Vendore dhe asaj Qendrore. Gjithashtu ai synon të vendosë marrëdhënie pune më të ngushta, më produktive e më bashkëpunuese në të gjitha hallkat qeverisëse.

Duke qenë se në Memorandum përfshihen të dy nivelet e qeverisjes ai do të nënshkruhet nga Shoqata e Komunave të Shqipërisë (SHKSH), Shoqata e Bashkive të Shqipërisë (SHBSH) dhe Shoqata e Këshillit të Qarqeve të Shqipërisë (SHQSH) nga njëra anë, si dhe nga Qeveria Qendrore.

Kjo marrëveshje që është iniciuar nga SHKSH, (Vijon në faqen 4)

## “Qeverisja elektronike”... një nismë për reduktimin e praktikave korruptive

-Sistemi i Prokurimit Elektronik do të sjellë ndryshime rrënjësore – Tashmë në vendin tonë funksionon Sistemi i Prokurimit Elektronik i cili është pjesë integrale e nismës së qeverisjes elektronike në Shqipëri. Kjo u arrit si rezultat i Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Koorporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit.

Padyshim që kjo masë shënon një arritje të re në aspektin e teknologjisë, por edhe në thellimin e reformave në sistemin e prokurimit dhe reduktion praktikave korruptive, ul informaltetit dhe përmirëson mjedisin për biznesin përmes një programi të bazuar në zgjidhje të teknologjise se informacionit (TI) dhe ndihmes teknike e ligjore.

Sistemi i Prokurimit Elektronik reformon praktikën e llogaridhenies, transparencës, qasjen e publikut dhe efektshmërinë. Zbatimi i këtij sistemi do të ndikojë në arrijtjen e objektivave në administratën tatimore, prokurimin publik dhe regjistrimin e biznesit. Në Reformën Tatimore nisma kryesore përfshin ligjin e ri për administratën tatimore i cili synon të përmirësojë ndjeshëm efikasitetin dhe mbledhjen e taksave si dhe për të pakësuar kontaktet me inspektorët tatimorë.

Në kuadër të reformës tatimor do të ketë një Qender të Shërbimit për tatimpaguesit për rajonin e Tiranës, një portal të ri dhe gjithpërfshirëse në internet nga i cili do të thithet më shumë informacion e do të ketë me pak nevojë për të shkuar në zyrat e tatimeve. Deklarimin i pagesës elektronike te taksave është një mundësi që u lehtëson punën dhe u kursen kohë dhe para tatimpaguesve.

Në prokurimet publike nisma përfshin edhe rritjen e kapacitetit profesional dhe të TIsë të Agjencise se Prokurimit Publik (APP) për të zbatuar procedurë transparente te prokurimit si rrjedhojë e aksesit publik në sistemin e ri të prokurimit elektronik, si dhe rritjes se ndërgjegjesimit per kuadrin e ri ligjor ne kete fushe.

Ndikim të dukshëm do të ketë edhe në regjistrimin e bizneseve, përmes Qendres Kombetare te Regjistrimit (QKR) si shërbimi me një ndalesë që redukton ndjeshëm kohën dhe kostot për të regjistruar një biznes të ri. Shërbimi me një ndalesë, brenda një dite për regjistrimin e biznesit, duke përfshirë njëkohësisht edhe regjistrimin për taksat, sigurimin shoqëror dhe Inspektorati i Punës përbëjnë një arritje të re bashkëkohore që është në përputhje me standartet e BE-se. Regjistri Tregtar Elektronik si dhe Ligji i ri i procedurave tatimore synojnë të përmirësojë ndjeshëm punën në administratë, të krijojnë një administratë moderne dhe të efektshme.

Në 9 prill 2008 QKR hapi ofertat e tenderit të pare plotesisht elektronik ne Shqiperi. Padyshim që kjo nismë do t'i shërbejë edhe Këshillave të Komunave, komisioneve përkatëse dhe gjithë administratës në përgjithësi. Sistemi i Prokurimit Elektronik në Shqipëri, si pjesë e qeverisjes elektronike do të sjellë ndryshime rrënjësore edhe në qeverisjen vendore në komunat.

## PROFIL KOMUNE

## KU NDODHET KOMUNA GOSTIMË?

Komuna Gostimë ndodhet në Qarkun e Elbasanit dhe shtrihet përgjatë rrugës nacionale në zonën e njohur të Shtatit. Gërmimet arkeologjike të kryera në fushën e Pozhokut, ku janë gjendur një sasi e madhe materiale, vërtetojnë se zona ku shtrihet komuna e Gostimës ka qenë e banuar qysh në lashtësi. Te gjithë banorët e kësaj zone i bashkon historia, traditat, zakonet e përbashkëta. Kufizohet; Nga Veriu me bashkinë e Cërrikut dhe komunën e Gjergjanit, nga Lindja me komunën Tregan, nga Jugu me lumin Devoll e komunën Grekan, nga Perëndimi me bashkinë e Beleshit dhe komunën e Shalësit. Komuna Gostimës shtrihet në një territor ku 70 % e tokës është fushore ndërsa pjesa tjetër kodrinore. Sipërfaqja e tokës bujqësore e ndare sipas ligjit 7501 date 19.08.1991 është 2627 ha.. 66.4 % është toke bujqësore e ujëtshme. Komuna ka 122 ha pyje, 613 ha kullota dhe toke inproduktive 368 ha te cilat se shpejt me VKM do te kalojnë ne pronësi te komunës ne kuadër te decentralizimit.

Fshati Gostime është qendra e komunës. Në komunë përfshihen 7 fshatra:

Fshati Gostime që ka 2180 banorë, 518 familje;

Fshati Gjyrale, 1500 banore me 337 familje;

Fshati Shtepanje me 2750 banore, 707 familje;

Fshati Shushice me 500 familje;

Fshati Shtërmën me 3400 banore, 774 familje;

Fshati Malasej me 1550 banorë, 325 familje,

Fshati Cartaloz me 400 banore, 106 familje.

Çdo fshat është i ndare nga 3-5-7 lagje sipas madhësisë së tyre.

Ne përgjithësi rrugët brenda fshatit si dhe rrugët që lidhin fshatrat janë të rikonstruara, ka edhe probleme ne këtë drejtim. Aktualisht komuna ka paraqitur projekte te plota për asfaltim te rrugëve pranë F.ZH.SH dhe Ministrisë se Brendshme për te përfutur nga grantet konkurruese për vitin buxhetor 2008. Me qendrat urbane komuna lidhet nëpërmjet rrugës kryesore Gostime- bashkia Cërrik komuna Paperr, bashkia Elbasan si dhe ne Jug-Lindje lidhet me bashkinë e Gramshit. Largësia midis dy fshatrave me te largët te komunës është 15 km.

## Ç'E DALLON GOSTIMËN?

Banorët e komunës merren kryesisht me bujqësi. Fermerët me kultivimin e bimëve bujqësore si drithëra buke, perime e bime foragjere, pemëtarë. Me të zhvilluara janë vreshtaria dhe ullishtat. Shi-

## GOSTIMA

het një tendence e krijimit te blloqeve te reja me vreshta e ullinj. Mbarështrihen kryesisht gjedhe. Sot ka rreth 3150 krerë lopë. Në të imta vendin kryesor e zë delja me 6300 krerë.

## 100 BIZNESE

Banorët e komunës po i përshtaten çdo ditë e më shumë ekonomisë së tregut. Ne territorin e Komunës operojnë 100 biznese te vegjël.. Fermerët i dërgojnë produktet për treg ne mënyre individuale me mjete transporti te vetat ose përmes firmave. Veçori paraqet sidomos shitja e qumështit i cili grumbullohet nga 2 biznesmenë përpunues te tij, njeri nga Elbasani dhe tjetri nga Librazhdi. Ata vijnë çdo ditë dhe e grumbullojnë atë nga ferm-



erët.. Por edhe vetë fermerët produktet bujqësore e blegtorale i tregtojnë ne qytetin e Cërrikut e atë të Elbasanit dhe, me rralle, ne tregun e qytetit te Lushnjës.

Duke qenë se komuna Gostimë ka tendence zhvillimin bujqësor, blegtoral e veçanërisht pemëtarinë e ardhmja kërkon rritjen e kapaciteteve përpunuese industriale te prodhimeve bujqësore e blegtorale siç janë baxhot e përpunimit te qumështit, linjat e përpunimit te mishit, punishte për prodhim vere e rakis si dhe linjat e prodhimit te vajit te ullirit. Një rendësi te veçante do t'i kushtohet sektorit te peshkimit sidomos ne fshatin Gjyrale ku gjenden 5 liqene natyrale. Ne komune ka potenciale qe te zhvillohet aktiviteti i prodhimit te materialeve te ndërtimit (guoret).

## PESHA E PESHËNGRITJES ...

Po në Komunën e Gostimës ka një që krejt të veçantë që e dallon: Është sporti i peshëngritjes. Ai që e ngre peshë entuziazmin e banorëve të komunës. Ne fshatin Shtërmën ka vite që funksionon Klubi Sportiv i Peshëngritjes. Në përbërje të tij ka sportiste e sportiste të talentuar

që kanë dalë nenkampion ne kampionatin shqiptar dhe pjesëmarrës edhe me përfaqësuesen e peshëngritjes së Shqipërisë në garat ndërkombëtare. Komuna i ka dhënë mbështetje te vazhdueshme ekipit te peshëngritjes te fshatit Shtërmën. Ndërtoi një palestër të re moderne. Ky investim u realizuar ne bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinise dhe Sporteve. Vetëm gjate vitit buxhetor 2007, komuna ka shpenzuar rreth 600.000 lekë për përmirësimin e kushteve te stërvitjes dhe sigurimin e pjesëmarrjes ne garat kombëtare. Në garat e fundit të Kampionatit Kombëtar dy sportistet e Klubit të Shtërmën, Briken Calja dhe Gerald Toska u shpallën kampione kombëtar, në peshat e tyre dhe janë kandidatë për ekipin kombëtar në garat e Kampionatit Europian. Sporti i peshëngritjes po bëhet gjithnjë e më i dashur në gjithë komunën dhe krenaria e saj.

## ARSIMI &amp; SHËNDETËSIA

Në komunën ka 6 shkolla 9-vjeçare dhe një shkollë të Mesme të Përgjithshme në fshatin Gostime nga ku, në 3 vitet e fundit, 40 % e maturantëve vazhdojnë studimet e larta. Ne sektorin e arsimit janë bërë 1.446.694 lekë shpenzime sipas kërkesave e nevojave të shkollave e kopshteve të zonës për mbarëvajtjen e punës në këto institucione te dijes se komunitetit tone, qe personeli mësimdhënës dhe nxënësit te kenë kushte mësimi e edukimi normal. Gjendja e shkollave le për të dëshiruar. Disa shkolla kanë nevojë për rikonstruksione dhe baze materiale për procesin mësimor ku përfshihen laboratorët e ndryshëm. Për këtë janë hartuar projekte të plota dhe janë dërguar pranë Ministrisë se Arsimit dhe Shkencës për te përfutur nga granti i buxhetit te shtetit dhe fondet e Bankës Botërore.

Në territorin e komunës Gostime ndodhen një qendër Shëndetësore ne fshatin Gostime dhe secili fshat ka ambulancën e tij ne gjendje te mire si objekte. Personeli shëndetësor përbehet nga 5 mjekë te ndare për shërbim sipas urdhrat te Drejtorisë se Shërbimit Parësor Elbasan (mjeket e familjes). Personeli infermier



përbehet nga 18 punonjës te ndare ne fshatra. Gjendja e qendrës shëndetësore Gostime dhe ambulancës ne çdo fshat është e mire d.m.th objektet janë te reja dhe te rikonstruara.

## UJI I PIJSHËM DHE UJITJA

## -Në fund te vitit 2008 përfundon së ndërtoari ujësjellësi i ri në fshatin Gostimë-

Furnizimi me ujë e sidomos me ujë të pijshëm është zgjidhur ne fshatrat Shtërmën, Shtepanje, Shushice, Gjyrale dhe Cartaloz. Këta fshatra furnizohen rreth 15 deri 20 ore në ditë me ujë te pijshëm. Është duke u ndërtuar ujësjellësi i ri ne fshatin Gostimë i cili përfundon ne fund te vitit buxhetor 2008. Problem kryesor ngelet fshati Malasej qe furnizohet 30 % e familjeve me 3 ore ne dite.

Sistemi i kullimit dhe i rrugëve te arave është ne gjendje te mire. Territori i komunës përshkohet nga lumi Devoll dhe nga zalli i Gostimes, por një burim kryesor për ujitje është lumi i Shkumbinit i cili nepermet kanalit ujitës "Naun Panxhi" ujit një sipërfaqe prej 800 ha. Komuna ka burime ujore te mjaftueshme për ujitje. Sistemi i ujitjes menaxhohen nga Shoqata e Përdoruesve te ujit.

## PROVAT PËR TË ARDHMEN

Detyrë parësore e komunës për komunitetin është rritja e te ardhurave dhe kryerja e shërbimeve me kosto sa me te ulet për banoret, përmirësimi i infrastrukturës rurale- ku futen sigurimi i ujit te pijshëm, garantimi i ujitjes, funksionimi sa me optimal i sistemit te kullimit, përdorimi i inputeve bujqësore te certifikuar si dhe zhvillimi i kapaciteteve përpunuese te produkteve bujqësore e blegtorale. Promotori i te gjithë këtij procesi mbetet komuna. Dhe komuna e Gostimës jep prova përditshmërie për të ardhmen.

## Asistencë teknike dhe trajnime për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve Publike në pushtetin vendor

Projekti "Asistencë teknike dhe trajnime për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve Publike në pushtetin vendor" financohet nga Bashkimi Evropian.

Data e fillimit të këtij projekti është 19 Prill 2007 dhe ka një kohëzgjatje prej 24 muajsh. Ky projekt nëpërmjet Shoqatave të të zgjedhurve vendorë do të asistojë njësitë e qeverisjes vendore për të përmirësuar administrimin publik të licencave, lejeve, autorizimeve nëpërmjet dy drejtimeve të mbështetjes:

- Së pari, zhvillimin e një strukture licencimi transparente, të thjeshtuar dhe të standardizuar - të qartë dhe të lehtë për tu përdorur

- Së dyti, të qartësojë nevojat e përmirësimeve organizative ne njësitë e qeverisjes vendore për procesin e dhënies së licencave.

Realizimi me sukses i këtij projekti parashikohet të rrisë shkallën e standardizimit dhe transparencën e procedurave te licencimit ne nivel vendor si dhe lehtësimin e biznesit.

Ai do të asistojë gjithashtu edhe nivelet e ndryshme të qeverisjes në Shqipëri duke pasur si qëllim të rrisë bashkëpunimin midis tyre me qëllim shpërndarjen sa më të mirë të detyrave dhe angazhimeve midis nivelit qendror dhe atij vendor.

Tre kompani EPTISA (Spanjë), Arcadis BMB (Hollandë) dhe Fondacioni për Reformën ne Qeverisjen Vendore FLGR

(Bullgari) janë përgjegjës për zbatimin e projektit.

Disa nga objektivat specifike të projektit janë :

- Dokumentimi dhe analizimi i situatës aktuale të licencimit në Shqipëri në bashkëpunim me Shoqatat e të zgjedhurve vendore.

- Rritja e shkallës së standardizimit të procedurave te licencimit ne nivelin vendor

- Rritja e transparencës së procedurave te licencimit në pushtetin vendor
- Lehtësimi i procedurave te licencimit.

- Zhvillimi i kapaciteteve administrative të qeverisjes vendore në fushën e licencimeve

- Rritja e bashkëpunimit midis niveleve te qeverisjes vendore dhe asaj vendore me qëllim harmonizimin dhe shpërndarjen e kompetencave.

Projekti ka zyrat e veta në ambientet e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë. Ai punon ngushtë dhe konsultohet me Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë, Shoqatën e Komunave të Shqipërisë dhe Shoqatën e Qarqeve të Shqipërisë si dhe projekte, partnerë dhe përfutues të tjerë për të kontribuar në përmirësimin e procedurave te licencimit në nivelin vendor.

Projekti është në përfundim të fazës së dytë, asaj të Pilotimit e cila do të finalizohet me një Konferencë Kombëtare në 4 Korrik.

## MEMORANDUMI I MIREKUPTIMIT – PIKE KULMORE NE PROCESIN E DECENTRALIZIMIT

(Vijon nga faqja 3)

do të jetë e para e këtij lloji në vendin tonë dhe do të shënojë një pikë kulmore në procesin e decentralizimit që ka nisur që në vitin 1992 në Shqipëri.

Nënshkrimi dhe vënia në zbatim e Memorandumit pa dyshim që pritet të nxisë dhe të zhvillojë dhe konsolidojë më tej tërësinë e parimeve të bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë Qendrore dhe asaj Vendore në shërbim të qytetarëve shqiptarë, t'i shërbejë çuarjes më përpara të decentralizimit në një kohë kur njësitë e qeverisjes vendore janë duke u përballur me sfida të rëndësishme që vijnë nga ndryshimet shoqërore e demografike, integrimi evropian dhe globalizimi. Kjo marrëveshje pritet të realizohet edhe një kohë kur qytetarët e Shqipërisë me të drejtë po rrisin kërkesat e tyre për shërbime publike cilësore nisur nga shpresat dhe ambiciet e tyre në rritje. Prandaj për të përmbushur këto sfida dhe aspirata, u gjykua që të përgatitet projekt i Memorandumit pasi dihet që komunitetet kanë nevojë për udhëheqje strategjike dhe shërbime publike të cilat duhet të përmirësohen vazhdimisht në cilësi e efikasitet dhe t'i ofrohen çdokujt njëjloj.

Memorandumi Mirëkuptimi do të çojë në një stad më të lartë marrëdhëniet mes qeverisjes vendore dhe asaj qendrore. Palët në marrëveshje do të punojnë së bashku për t'i zhvilluar edhe më tej ato duke marrë secila përsipër detyrime dhe angazhime.

Nënshkrimi dhe vënia në jetë e kësaj marrëveshjeje ka si qëllim të përcaktojë parime që udhëheqin marrëdhëniet ndërmjet niveleve të qeverisjes për çështjet e qeverisjes vendore si dhe të përmirësojë procesin e këshillimeve, praktikave e komunikimit të qeverisjes.

Kjo marrëveshje nuk synon të krijojë një marrëdhënie të detyrueshme ligjore ndërmjet palëve, ndërkohë që parimet dhe proceset, të cilat shprehen në të, synojnë të udhëheqin qëndrimet dhe praktikat bazë të bashkëpunimit midis niveleve të qeverisjes në sferën e kompetencave të veta, të përbashkëta apo të deleguara duke synuar krijimin e sinergjisë së nevojshme për bashkërendimin e përpjekjeve midis dy niveleve të qeverisjes në funksion të përdorimit sa më efikas të burimeve njerëzore, kapitale dhe materiale.